

**Njoftim për përqendrim me të cilin shoqëria aksionare Telekom Serbia, Beograd, Republika e Serbisë do të fitoj kontrollin e vetëm mbi KDS INTERNET TV SHPK ZAJEÇAR, Republika e Serbisë**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 15.08.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet marrjes së kontrollit individual nga shoqëria aksionare Telekom Serbia, Beograd, me seli në rrugën Takovska numër 2, Beograd, Republika e Serbisë mbi shoqërinë KDS INTERNET TV SHPK ZAJEÇAR, me seli në rrugën Millosha Velikog numër 2, banesa 59, Zajeçar, Republika e Serbisë.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

**Shoqëria aksionare Telekom Serbia, Beograd** është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimit elektronik, e regjistruar për telekomunikacion kabllor dhe nga shërbimet që ofron veçojmë shërbimet për telefoni fikse dhe mobile, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Shoqëria aksionare Telekom Serbia, Beograd, ka një person juridik të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e së cilës është e regjistruar në rrugën Maksim Gorki 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikacionit me tela, gjegjësisht për ofrimin e shërbimet të mëposhtme: Rrjet publik i radio-komunikimit, akses në internet me brez të gjerë, shërbime ndër-operatore, shërbime telefonike që janë në dispozicion për publikun në një rrjet publik komunikimi celular, ritransmetim të shërbimeve programore televizive, satelitore.

**KDS INTERNET TV SHPK ZAJEÇAR** është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimit elektronik, e regjistruar për ofrimin e shërbimit të internetit dhe shërbimit të qasjes në internet në territorin e Republikës së Serbisë.

KDS INTERNET TV SHPK ZAJEÇAR nuk ka persona juridikë të lidhur, as nuk ka realizuar të ardhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lidhur me **tregun relevant të mallrave** për përqendrimin në fjalë, parashtruesi propozon që i njëjti të mund të përkufizohet si treg me pakicë për ofrimin e shërbimeve të aksesit në internet me brez të gjerë.

Lidhur me **tregun gjeografik** për përqendrimin në fjalë, parashtruesi propozon se i njëjti mund të përkufizohet si territor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

18.08.2023

Shkup